



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 37

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 19 mars 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 141, datë 13.3.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar..... 2323
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 13.3.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar. 2325
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 144, datë 13.3.2018	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri elektronik i subjekteve kontrolluese”..... 2326
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 145, datë 13.3.2018	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri elektronik i kërkesave dhe i përgjigjeve për të drejtën e informimit” 2327
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 146, datë 13.3.2018	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencive rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve..... 2329
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 13.3.2018	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor..... 2331
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 148, datë 13.3.2018	Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimorë e koordinues institucionalë, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës..... 2332
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 149, datë 13.3.2018	Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare..... 2336

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 150, datë 13.3.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”	2352
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 132, datë 16.2.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 4, datë 21.5.2015, “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo të revokimit të tyre”, të ndryshuar.....	2353
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 15, datë 12.3.2018	Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit nga lista shumemërore për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Lezhë z. Suri Damzi, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”	2354
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 3793, datë 7.3.2018	Për botimin e datës së hyrjes në fuqi të disa marrëveshjeve.....	2357
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Xhavid Salia.....	2358

**VENDIM****Nr. 141, datë 13.3.2018**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 54, DATË 5.2.2014, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË
PROCEDURËS E TË MËNYRËS SË
DHËNIES ME QIRA, ENFITEOZË APO
KONTRATA TË TJERA TË PASURISË
SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, të miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, dhe të neneve 784 e 801, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Kudo në vendim, emërtimet “Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” dhe “Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave” zëvendësohen, përkatësisht, me fjalët “... institucioni përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme ...” dhe “... institucioni përgjegjës për kthimin dhe kompensimin e pronave ...”.

2. Në kreun I bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “g”, e pikës 5, riformulohet, si më poshtë vijon:

“g) Dhënia me qira e pasurive shtetërore, që janë të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës së prokurimit publik, kundrejt subjekteve private, që janë shpallur fitues dhe kanë lidhur kontratë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.”;

b) Në shkronjën “c”, të pikës 6, fjalia e dytë zëvendësohet me fjalinë, si më poshtë vijon:

“Afati i lidhjes së kontratës për këto pasuri, për sipërfaqet 200–500 m² është deri në 10

(dhjetë) vjet, ndërsa për sipërfaqet mbi 500 m² është deri në 20 (njëzet) vjet.”.

3. Në kreun II bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pikat 7 dhe 8 riformulohen, si më poshtë vijon:

“7. Dokumentacioni për marrjen me qira, që paraqesin konkurrentët, i dorëzohet komisionit në orën e hapjes së konkurrimit dhe përmban:

a) Kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore, ku të deklarohej oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurrimit, të parashikuar sipas planit të biznesit.

b) Planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, në të cilin duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm:

- Identiteti i subjektit kërkues, historiku i aktivitetit që kryen;

- Përshkrimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i burimeve financiare të investimit;

- Analiza e detajuar e afateve kohore, që do të duhen për të realizuar projektin investues, si dhe fazat e përcaktuara të realizimit të tij;

- Niveli i punësimit, që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara.

Nëse kërkesa e subjektit është për një afat kohor mbi 5 (pesë) vjet, plani i biznesit të jetë i përshkruar hollësisht, me të dhënat për 5 (pesë) vitet e para të aktivitetit dhe parashikimin për periudhën tjetër.

c) Deklaratat në formën e vetëdeklarimit, si më poshtë vijon:

- Deklaratë për të dhënat e NIPT/NUIS të subjektit kërkues;

- Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore;

- Deklaratë për administratorin dhe subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;

- Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte, pronë shtetërore, deklaratë për shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt, të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore;

- Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në çdo rast, komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.



Ky dokumentacion duhet të plotësohet edhe në rastet kur objekti jepet me qira pa konkurrim.

8. Dokumentacioni për marrjen me enfiteozë, që paraqesin konkurrentët, të cilët duhet të jenë shoqëri tregtare, i dorëzohet komisionit dhe përmban:

a) Kërkesën e subjektit për marrje me enfiteozë të pasurisë shtetërore, ku të deklarohet oferta për vlerën e detyrimit mujor, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit kryesorë financiarë të parashikuar sipas planit të biznesit;

b) CV-në e subjektit, ku të tregohet përvoja në fushën e aktivitetit ekonomik që do të ushtrohet në pasurinë që jepet me enfiteozë, të shoqëruar me dokumentacion vërtetues;

c) Planbiznesin e hollësishëm për përmirësimin e pronës;

ç) Përshkrimin e projekteve të investimit, të dhëna për nivelin e investimeve të parashikuara në pasuri të paluajtshme dhe në objektin në tërësi, shoqëruar me projekte, skica dhe dokumentacion tjetër paraprak, si dhe burimin e financimit të projektit;

d) Deklaratat, në formën e vetëdeklarimit, si më poshtë vijon:

- Deklaratë për të dhënat e NIPT/NUIS të subjektit kërkuar;

- Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore;

- Deklaratë për administratorin dhe për subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;

- Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte, pronë shtetërore, deklaratë për shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore;

- Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në çdo rast, komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.”.

c) Shkronja “c”, e pikës 9, riformulohet si më poshtë vijon:

“c) Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve bën shqyrtimin e ofertave të paraqitura, verifikon dokumentacionin e paraqitur nëpërmjet platformës elektronike *e-Albania* ose nëpërmjet komunikimit e

ndërveprimi ndërinstitucional, sipas përcaktimit në urdhrin e titullarit, dhe vlerëson me pikë çdo element konkurrimi, sipas përcaktimit në urdhrin e titullarit. Subjektit, i cili paraqet vlerën më të lartë të propozuar, i jepen pikët maksimale të çdo elementi konkurrimi, ndërsa subjekteve të tjera pikët u llogariten në përpjesëtim të drejtë me vlerën më të lartë të propozuar. Në përfundim, konkurruesit renditen në bazë të shumës së pikëve të përfituara.

Në rast se rezultojnë të dhëna të ndryshme nga të dhënat e dokumentacionit të paraqitur në formën e vetëdeklarimit në konkurrim, automatikisht subjekti skualifikohet, ndërsa procedurat vazhdojnë me subjektin e klasifikuar në vendin e dytë.

Metodologjia e vlerësimit të kriterëve të konkurrimin parashikohet në udhëzimin që do të dalë në zbatim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar.”.

ç) Në fund të pikës 14 bëhet shtesa, me këtë përmbajtje:

“Kthimi i garancisë së kontratës realizohet pasi të jenë shlyer të gjitha detyrimet e marrëveshjes kontraktore. Në rast se kontrata zgjidhet nga qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi, për shkaqe, për të cilat qiradhënësi ose enfiteozëdhënësi nuk mund të mbajë përgjegjësi, garancia mbahet si penalitet.”.

4. Në kreun IV bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë vijon:

a) Në paragrafin e parë të pikës 1, fjalët “... vërteton që në llogaritë ...” zëvendësohen me “... vërteton, nëpërmjet ekspertit kontabël të miratuar, që në llogaritë ...”.

b) Në fund të pikës 3 shtohet fjalia “Specifikimet për rastet dhe procedurat për ndryshimin e këtyre kontratave bëhen me udhëzim të ministrit përgjegjës për ekonominë.”.

5. Pika 5, në kreun V, riformulohet si më poshtë vijon:

“5. Në kontratën me tarifë 1 euro/kontrata vendosen sanksione për rastet kur qiramarrësi nuk realizon kushtet e saj. Bazuar në parashikimet e kontratës, për çdo vend pune të pahapur, si mesatare vjetore, subjekti qiramarrës penalizohet me 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Për mosrealizimin e vlerës së investimit të parashikuar në kontratë, subjekti qiramarrës penalizohet me 10



për qind të vlerës së investimit të përcaktuar. Ky sanksion do të vendoset pas dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore të certifikuara nga eksperti kontabël i miratuar.

Nëse pas 6 (gjashtë) muajve investimi nuk realizohet, kontrata zgjidhet në mënyrë të njëanshme nga institucioni qiradhënës, duke mbajtur garancinë e kontratës.”.

6. Në paragrafin e tretë, të pikës 4, të kreut VIII, fjalët “... në vendimin nr. 187, datë 6.3.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Shqipërisë”, ...” zëvendësohen me “... sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi ...”.

7. Në kreun IX, emërtimi “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” zëvendësohet me fjalët “... ministria përgjegjëse për ekonominë ...”.

8. Kudo në këtë vendim, emërtimi “ekspert kontabël i autorizuar” zëvendësohet me “ekspert kontabël i miratuar”.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 142, datë 13.3.2018

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 926, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRITERET E
VLERËSIMIT TË PRONËS
SHTETËRORE, QË PRIVATIZOHET APO
TRANSFORMOHET, DHE
PROCEDURËN E SHITJES”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në kreun I bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Këtij vendimi i nënshtrohen të gjitha ndërmarrjet apo objektet e veçuara, mjetet kryesore, mjetet e xhiros në administrim apo në ruajtje të institucioneve, ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror, për të cilat është dhënë miratimi i ministrit përgjegjës për ekonominë për fillimin e procedurave të privatizimit apo të transformimit në shoqëri tregtare.”.

b) Paragrafi i parë, në pikën 2, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Institucionet qendrore dhe organet e njësive të vetëqeverisjes vendore dërgojnë kërkesat e tyre për privatizimin e ndërmarrjeve apo të institucioneve që kanë në varësi administrative ose në pronësi, në ministrinë përgjegjëse për ekonominë. Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr urdhrin e miratimit për privatizim, sipas kërkesave të përmendura më sipër. Në rast se ministria përgjegjëse për ekonominë u kërkon institucioneve qendrore apo organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore kërkesën për prononcim privatizimi për pasuritë e ndërmarrjeve apo të institucioneve që kanë në varësi administrative, këto institucione janë të detyruara që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, të dërgojnë mendimin e tyre për privatizimin e këtyre pasurive.”.

2. Pika 12, në kreun II, ndryshohet si më poshtë vijon:

“12. Për dokumentacionin e përgatitur nga komisioni i vlerësimit ndiqet kjo procedurë:

a) I dërgohet ministrit përgjegjës për ekonominë:

i) për objektet ndërtimore, linjat e prodhimit/shërbimit, ku përcaktohen vlera e objektit, sipërfaqja e përgjithshme, ajo nën objekt dhe ajo funksionale;

ii) për makineritë, pajisjet, mjetet e transportit, inventarin ekonomik, mjetet e xhiros etj., kur asetet do të shiten të veçanta.



b) Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pasi kontrollon nëse ky dokumentacion ka kaluar në strukturat përkatëse, ia përcjell atë Komisionit të Shqyrtimit dhe Transparencës, të ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë, për verifikimin, konfirmimin dhe transparencën e procedurës së dokumentacionit të privatizimit të pronës shtetërore, që dërgohet për shitje;

c) Komisioni i Shqyrtimit dhe Transparencës, i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë, ka në përbërje:

- zëvendësministrin e Financave dhe Ekonomisë, kryetar;
- një përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe të Përputhshmërisë, MFE, anëtar;
- dy përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, MFE, anëtar;
- një përfaqësues të Drejtorisë së Auditimit, MFE, anëtar.

ç) Komisioni i Shqyrtimit dhe Transparencës i rekomandon ministrit përgjegjës për ekonominë vijimin e procedurës së privatizimit nga struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike, nëse ekziston dokumentacioni i kërkuar ligjor dhe ka kaluar në të gjitha strukturat e parashikuara në këtë vendim.

Në rast të kundërt, Komisioni i Shqyrtimit dhe Transparencës kërkon plotësimin e dokumentacionit.

d) Detyrat, mënyrat e vlerësimit dhe procedura e mbledhjes së Komisionit të Shqyrtimit dhe Transparencës përcaktohen në udhëzimin e dalë në zbatim të vendimit nr. 926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar.”.

3. Fjalja e parë e pikës 19, në kreun III, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Komisioni i ankandit kryesohet nga përfaqësuesi i strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës publike dhe në përbërje të tij ka anëtarë:

- përfaqësuesin e organit që ka në pronësi, ruajtje apo në varësi administrative objektin;
- përfaqësuesin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.”.

4. Pika 9, në kreun IV, ndryshohet si më poshtë vijon:

“9. Për kontratat e shitjes, të deklaruara të pavlefshme me vendim gjykatë të formës së prerë, duke kthyer palët në gjendjen e mëparshme, procedurat e rivlerësimit të objektit bashkë me truallin do të bëhen sipas kreut II të këtij vendimi, dhe legjislacionit në fuqi për privatizimin.”.

5. Kudo në vendim, fjalët “... ministria përgjegjëse për ekonominë ...” dhe “... Ministria e Financave...” zëvendësohen me emërtimin “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”.

6. Kudo në vendim, fjalët “... Drejtori i Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike ...” dhe “... Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, ...”, zëvendësohen me “... Struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 144, datë 13.3.2018

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE “REGJISTRI ELEKTRONIK I SUBJEKTEVE KONTROLLUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin, në zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “KDIMDP”), e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri elektronik i subjekteve kontrolluese” (në vijim “RESK”), përmbajtja e së cilës publikohet në faqen zyrtare të KDIMDP-së.

2. KDIMDP-ja është përgjegjëse për krijimin, mbajtjen, administrimin, ndërveprimin me bazat e tjera dhe bërjen të disponueshëm të informacionit në përmbajtje të bazës së të dhënave “Regjistri elektronik i subjekteve kontrolluese”.

3. RESK-u përmban të dhëna për:

a) Qëllimin, mënyrat dhe mjetet e përpunimit të të dhënave personale nga kontrollues publikë dhe privatë;



b) Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen;

c) Të dhënat sensitive që përpunohen;

ç) Masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Të dhënat që përmban RESK-u ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore janë:

i) të dhënat e kontrolluesit;

ii) fusha e veprimtarisë;

iii) kategoritë e subjekteve të të dhënave personale;

iv) kategoritë e të dhënave personale që përpunohen;

v) të dhënat sensitive që përpunohen;

vi) qëllimet e përpunimit të të dhënave;

vii) marrësi/t i/e të dhënave personale;

viii) transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale;

ix) mjetet e përpunimit të të dhënave personale;

x) masat e sigurisë dhe politikat e ruajtjes së të dhënave personale.

b) Të dhëna dytësore janë:

i) NIPT-i;

ii) emri/mbiemri;

iii) nr. tel./faksi;

iv) adresa.

5. Dhënësi i informacionit për RESK-un është KDIMDP-ja.

6. Niveli i aksesit në sistemin dhe bazën e të dhënave të RESK-ut është si më poshtë vijon:

a) Qytetarët (subjekte të të dhënave personale) kanë nivel aksesit si lexues dhe konsultues, lidhur me informacionin e vënë në dispozicion, nëpërmjet faqes së internetit të KDIMDP-së.

b) Kontrolluesit publikë dhe privatë, të cilët përpunojnë të dhëna personale, kanë të njëjtin nivel aksesit si ai i parashikuar në shkronjën “a” të kësaj pike.

c) KDIMDP-ja ka akses si administrator dhe përdorues në RESK. Niveli i aksesimit, funksionet dhe të drejtat për secilën kategori konsultuesish dhe përdoruesish të sistemit, si dhe për punonjësit e KDIMDP-së janë në përputhje me pozicionin e punës dhe përcaktohen në rregulloren “Për sigurinë e bazave të të dhënave shtetërore të krijuara në KDIMDP”, miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

7. Baza e të dhënave të KDIMDP-së ndërvepron me kontrolluesit publikë dhe privatë, sipas ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, si dhe ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

8. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën *software* dhe *hardware* të RESK-ut në KDIMDP, të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe praktikave evropiane e ndërkombëtare në fushën mbrojtjes së të dhënave, bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

9. Ngarkohet zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 145, datë 13.3.2018

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHETETËRORE “REGJISTRI ELEKTRONIK I KËRKESAVE DHE I PËRGJIGJEVE PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin, në zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “KDIMDP”), e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit” (në vijim “REKPDI”), përmbajtja e së cilës do të publikohet në portalin “Pyetshtetin.al”.

2. KDIMDP-ja është përgjegjëse për krijimin, mbajtjen, administrimin e bazës së të dhënave “Regjistri elektronik i kërkesave dhe i përgjigjeve për të drejtën e informimit”, dhe ndërveprimin e përmbajtjes së tij me bazat e tjera të informacionit.



3. REKPDI-ja përbën një bazë gjithëpërfshirëse të të dhënave lidhur me kërkesat për informim të depozituara pranë autoriteteve publike në kuptim të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, dhe përgjigjet e dhëna prej tyre.

4. Të dhënat e REKPDI-së përditësohen çdo 3 (tre) muaj nga koordinatorët e së drejtës për informim të secilit autoritet publik, të cilit i drejtohet kërkesa për informim. Gjithashtu, REKPDI-ja lejon mundësinë e paraqitjes së kërkesave për informim nga subjektet e interesuara drejtpërsëdrejti dhe përgjigjja nga autoriteti publik do të jepet drejtpërsëdrejti në REKPDI-ja.

5. REKPDI-ja përmban të dhëna për:

a) Autoritetet publike dhe kontaktet e koordinatorëve të së drejtës për informim;

b) Kërkesat për informacion publik dhe përgjigjet e dhëna nga çdo autoritet publik;

c) Ankesat e depozituara pranë KDIMDP-së.

6. Të dhënat që përmban sistemi ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen ato të dhëna, të cilat grumbullohen nga ky regjistër dhe përfshijnë:

i) emrin e autoritetit publik;

ii) të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit;

iii) kërkesat për informacion publik dhe përgjigjet adresuar këtyre kërkesave;

iv) ankesat e depozituara pranë KDIMDP-së.

b) Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat që merren nga autoriteti publik dhe përfshijnë:

i) adresat e kërkuesve;

ii) të dhëna identifikuese të kërkuesve apo të dhëna të paraqitura në kërkesat për informacion publik, si: emër/mbiemër, nr. tel./faksi, adresa postare dhe elektronike.

7. Dhënës i informacionit për këtë bazë të dhënash janë autoritetet publike, nëpërmjet koordinatorëve të tyre për të drejtën e informimit, si dhe qytetarët, të cilët depozitojnë në të ankesa në formë elektronike.

8. Niveli i aksesimit në sistemin dhe bazën e të dhënave të REKPDI-së është si më poshtë vijon:

a) Qytetarët kanë nivel aksesit si lexues dhe dërgues të kërkesave për informacion publik nëpërmjet portalit “Pyetshtetin.al”.

b) Koordinatorët e së drejtës për informim të secilit autoritet publik kanë akses si lexues dhe

përdorues në sistem nëpërmjet regjistrimit të kërkesave për informacion publik që u adresohen autoriteteve publike që ata përfaqësojnë. Ata do të pajisen me një llogari nëpërmjet së cilës do të marrin kërkesat për informacion dhe do të kthejnë përgjigjet e adresuara nëpërmjet portalit “Pyetshtetin.al”, si dhe do të ngarkojnë (*upload*) në REKPDI kërkesat për informacion publik, të adresuara drejtpërsëdrejti pranë autoritetit publik, së bashku me përgjigjet përkatëse.

c) KDIMDP-ja ka akses si administrator dhe përdorues në REKPDI. Niveli i aksesimit, funksionet dhe të drejtat për secilën kategori konsultuesish dhe përdoruesish të sistemit, si dhe për punonjësit e KDIMDP-së janë në përputhje me pozicionin e punës dhe përcaktohen në rregulloren “Për sigurinë e bazave të të dhënave shtetërore të krijuara në KDIMDP”, miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

9. Funksionet dhe të drejtat e secilit përdorues janë në përputhje me pozicionin e punës dhe të përcaktuara në rregulloren e parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 8, të këtij vendimi, në përputhje me ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”.

10. Baza e të dhënave të REKPDI-së ndërvepron me bazën e të dhënave të autoriteteve publike, sipas ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, dhe ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

11. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën *software* dhe *hardware* të REKPDI-së, të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe praktikave evropiane e ndërkombëtare, bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

12. Ngarkohen zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe autoritetet publike në kuptim të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

**VENDIM****Nr. 146, datë 13.3.2018****PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AGJENCIVE
RAJONALE TË SHËRBIMIT VETERINAR
DHE MBROJTJES SË BIMËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të nenit 128, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 3, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e agjencive rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve (ARSHVMB), si persona juridikë publikë, në varësi të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, me seli në Shkodër, Tiranë, Vlorë dhe Elbasan. Agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve financohen nga buxheti i shtetit, i miratuar për ministrinë përgjegjëse.

2. Agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve (ARSHVMB) e shtrijnë veprimtarinë e tyre, si më poshtë vijon:

a) ARSHVMB-ja Shkodër përfshin qarqet Lezhë, Shkodër dhe Kukës;

b) ARSHVMB-ja Tiranë përfshin qarqet Durrës, Tiranë dhe Dibër;

c) ARSHVMB-ja Vlorë përfshin qarqet Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë;

ç) ARSHVMB-ja Elbasan përfshin qarqet Korçë, Elbasan dhe Berat.

3. Agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve kanë mision të zbatojnë politikat dhe strategjitë për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, kafshëve, bimëve dhe mjedisit.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Shërbimit Veterinar në agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve janë, si më poshtë vijon:

a) Zbaton politikat e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve të gjalla, si dhe programet e parandalimit, të kontrollit, eliminimit deri në çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, sipas përcaktimeve të legjislacionit veterinar;

b) Zbaton strategjitë afatshkurtra, afatmesme e afatgjata të veprimtarive veterinarë;

c) Zbaton legjislacionin veterinar;

ç) Monitoron dhe harton raporte për situatën epidemiologjike të sëmundjeve infektive në kafshë në territorin e caktuar, në rajonin përkatës, në bashkëpunim me strukturat që kryejnë veprimtari veterinarë;

d) Administron mjetet financiare për mbrojtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve, mbrojtjen nga zoonozat;

dh) Mbron shëndetin dhe mirëqenien e:

i) kafshëve në mbarështimin e tyre;

ii) kafshëve në prodhimin dhe ruajtjen e produkteve embrionale;

iii) kafshëve në tregtimin, shkëmbimin dhe transportimin e kafshëve e të produkteve embrionale;

iv) kafshëve të shoqërimit;

v) kafshëve të laboratorit;

e) Mbikëqyr e kontrollon prodhimin, ruajtjen, tregtimin dhe përdorimin e produkteve mjekësore veterinarë, të dezinfektantëve e dezinfestantëve të certifikuar, që prodhohen ose tregtohen në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) Mbikëqyr e kontrollon biosigurinë, dezinfektimin, dezinfektimin, deratizimin dhe shkatërrimin e materialeve të infektuara;

f) Mban dhe përditëson regjistrin zyrtar për:

i) fermat dhe stabilimentet blegtorale;

ii) subjektet që tregtojnë kafshë;

iii) subjektet që prodhojnë, ruajnë e tregtojnë produkte embrionale;

iv) individët që transportojnë kafshë, produkte embrionale, nënprodukte me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor;

v) qendrat e grumbullimit të kafshëve ose pikat karantinore;

vi) subjektet që prodhojnë ose tregtojnë PMV;

vii) laboratorët veterinarë;

viii) vendet ku zbatohet praktika mjekësore veterinarë dhe mjekët veterinarë që punojnë atje;

ix) institucionet dhe personat që lejohen të kryejnë eksperimente me kafshë.

g) Zbaton procesin e identifikimit e të regjistrimit të kafshëve dhe fermave blegtorale, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.

5. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve janë, si më poshtë vijon:



a) Monitoron gjendjen fitosanitare të bimëve, produkteve bimore dhe të objekteve të tjera brenda territorit në administrimin e tyre;

b) Kryen kontrollin fitosanitar dhe pajis me “Certifikatë fitosanitare të brendshme” bimët ose produktet bimore të afta për të mbartur parazitë karantinorë apo të rrezikshëm, që lëvizin brenda territorit të vendit;

c) Kryen kontrollin fitosanitar dhe pajis me “Certifikatë fitosanitare për eksport” bimët ose produktet bimore të afta për të mbartur parazitë karantinorë apo të rrezikshëm, që lëvizin jashtë territorit të vendit;

ç) Kryen kontrollin fitosanitar dhe pajis me “Certifikatë fitosanitare për riekspor” bimët ose produktet bimore në rastin e hyrjes në territorin e vendit, për qëllim riekspori, dhe të qëndrimit të tyre brenda vendit për më shumë se 14 ditë;

d) Kryen kontrollin fitosanitar dhe pajis me “Certifikatë fitosanitare” materialet bimore për shumëzim ose mbjellje;

dh) Kryen monitorimin e parazitëve të bimëve të kultivuara apo spontane, si dhe të fondeve për mbrojtjen e bimëve, që planifikohen në buxhetin vjetor për ministrinë;

e) Njofton menjëherë SPMB-në kur në një zonë shfaqet një parazit karantinor, si dhe, me shpalljen e kësaj zone si zonë e prekur, ndjek masat për kufizimin e përhapjes së parazitit karantinor, deri në çrrënjosjen e tij në zonën përkatëse;

ë) Ndjek zbatimin e praktikave të mira të mbrojtjes së bimëve, si dhe të kritereve të mbrojtjes së integruar;

f) Ndjek zbatimin e masave të veçanta për rastet emergjente të përhapjes e të shtimit masiv të parazitëve, të cilët nuk mund të kufizohen me metodat e zakonshme të kontrollit;

g) Ofron trajnim të përshtatshëm dhe lëshon dëshmi aftësie për përdorimin e PMB-ve;

gj) Ofron informacion për gjithë komunitetin e fermerëve dhe publikun, nëpërmjet medias;

h) Zbaton strategjitë afatshkurtra, afatmesme e afatgjata të veprimtarive të mbrojtjes së bimëve;

i) Ndjek dhe zbaton detyra të tjera, të përcaktuara në ligjin nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, si dhe në aktet nënligjore të tij.

6. Agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve mbajnë lidhje të vazhdueshme dhe koordinojnë veprimtarinë e

tyre me institucionet kërkimore-shkencore dhe burime të tjera informacioni.

7. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të agjencive rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil.

Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë të këtyre agjencive rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

8. Strukturat dhe organikat e agjencive rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve miratohen nga Kryeministri, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

9. Për nëpunësit civilë aktualë të drejtorive të bujqësisë zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit. Për punonjësit administrativë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

10. Rregulloret, që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të agjencive rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve, miratohen nga ministri përgjegjës për bujqësinë.

11. Pasuritë e luajtshme e të paluajtshme të sektorëve të shërbimit veterinar në drejtoritë e bujqësisë, sipas qarqeve, të kalojnë në përgjegjësi administrimi të agjencive rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve. Kalimet të bëhen në referencë të bilancit kontabël në datën e dorëzimit dhe marrjes në dorëzim. Dorëzimi dhe marrja në dorëzim të bëhet nga një komision i përbashkët, i ngritur nga dy institucionet përkatëse.

12. Drejtoritë e bujqësisë të vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre deri në momentin e krijimit dhe të fillimit të funksionimit të agjencive rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve në Shkodër, Tiranë, Vlorë dhe Elbasan.

13. Secila nga agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, emri i rajonit”, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 474, datë 10.7.2003. të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj”, të ndryshuar.



14. Vula e secilës prej agjencive rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”, të ndryshuar. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

15. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 147, datë 13.3.2018

PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCIVE RAJONALE TË EKSTENSIONIT BUJQËSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor si persona juridikë publikë, në varësi të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, me seli në Shkodër, Tiranë, Lushnjë dhe Korçë. Agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor financohen nga buxheti i shtetit, i miratuar për ministrinë përgjegjëse.

2. Agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor (AREB) e shtrijnë veprimtarinë e tyre, si më poshtë vijon:

a) AREB-ja Shkodër përfshin qarqet Lezhë, Shkodër dhe Kukës;

b) AREB-ja Tiranë përfshin qarqet Durrës, Tiranë dhe Dibër;

c) AREB-ja Lushnjë përfshin qarqet Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë;

ç) AREB-ja Korçë përfshin qarqet Korçë, Elbasan dhe Berat.

3. Agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor kanë si mision të tyre të bëhen faktorë kryesorë në zhvillimin e sektorit bujqësor konkurrues dhe të qëndrueshëm në vend, duke punuar në partneritet afatgjatë me përfituesit.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor janë si më poshtë:

a) Të ofrojnë informacion dhe këshillim për zhvillimin teknik e teknologjik të fermave bujqësore, me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë në bujqësi;

b) Të ofrojnë informacion dhe të asistojnë fermerët për të përfituar nga skemat mbështetëse kombëtare, IPARD-i dhe projekte të tjera në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;

c) Të nxisin dhe të ndihmojnë krijimin e funksionimin e formave të ndryshme të kooperimit të fermerëve;

ç) Të organizojnë dhe të kryejnë trajnimin profesional të fermerëve në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;

d) Të sigurojnë informacion për standardet lidhur me mjedisin, cilësinë, marketingun, bujqësinë organike, produktet me tregues gjeografikë etj.;

dh) Të informojnë dhe të këshillojnë fermerët për përzgjedhjen dhe përdorimin e makinerive e të pajisjeve bujqësore;

e) Të ofrojnë informacion të përgjithshëm për të gjithë komunitetin e fermerëve dhe për publikun nëpërmjet masmedias.

5. Detyra të tjera mbështetëse dhe administrative të agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor janë si më poshtë:

a) Të marrin pjesë në hartimin e skemave mbështetëse dhe implementimin e programeve të zhvillimit në bujqësi;

b) Të kryejnë vrojtime për sistemin e të dhënave të kontabilitetit të fermës (FADN);

c) Të marrin pjesë në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe parashikimin e prodhimit bujqësor e blegtoral dhe në vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fenomene natyrore në bujqësi etj.;

ç) Të sigurojnë trajnimin e vazhdueshëm të ekstensionistëve;

d) Të ofrojnë shërbime për fermat bujqësore, institucionet, njësitë e qeverisjes vendore (si plane zhvillimi, programe investimi, plane biznesi, plane të menaxhimit ekonomik, programe të zhvillimit rural, analiza etj.);



dh) Të kryejnë detyra të tjera të ngarkuara nga ministria përgjegjëse për bujqësinë.

6. Agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor mbajnë lidhje të vazhdueshme dhe koordinojnë veprimtarinë e tyre me institucionet kërkimore-shkencore dhe burime të tjera informacioni.

7. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës të punonjësve administrativë të këtyre agjencive rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

8. Strukturat dhe organikat e agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

9. Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor miratohen nga ministri përgjegjës për bujqësinë.

10. Nëpunësit e agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor që kryejnë funksione ekstensionit duhet të trajnohen, të testohen dhe të pajisen me certifikatën përkatëse për ofrimin e shërbimeve të ekstensionit.

Trajnimi, testimi dhe pajisja me certifikatë e nëpunësve të ekstensionit për ofrimin e shërbimeve këshilluese në bujqësi dhe zhvillimin rural bëhen në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

11. Secila nga agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor, emri i rajonit”, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj”, të ndryshuar.

12. Vula e secilës prej agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”, të ndryshuar. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

13. Pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të sektorëve të ekstensionit bujqësor në drejtoritë e bujqësisë sipas qarqeve të kalojnë në përgjegjësi administrimi të agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor. Kalimet të bëhen në referencë të bilancit kontabël në datën e dorëzimit dhe të marrjes në dorëzim. Dorëzimi dhe marrja në dorëzim të bëhen nga komisionet e përbashkëta të institucioneve përkatëse.

14. Për nëpunësit civilë aktualë të drejtorive të bujqësisë, në rastin e mbylljes dhe të ristrukturimit të institucionit, zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil. Për punonjësit administrativë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

15. Drejtoritë e bujqësisë të vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre deri në momentin e krijimit dhe fillimit të funksionimit të agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor Shkodër, Tiranë, Lushnjë dhe Korçë.

16. Vendimi nr. 960, datë 25.10.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e drejtorive të bujqësisë”, shfuqizohet.

17. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 148, datë 13.3 2018

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET MEKANIZMAVE KËSHILLIMORË E KOORDINUES INSTITUCIONALË, STRUKTURAVE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS DHE ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE, PËR REALIZIMIN E POLITIKAVE KOMBËTARE E VENDORE, SI DHE PËR SHËRBIMET E NEVOJSHME PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 34, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

KREU I

FUSHAT E BASHKËPUNIMIT DHE
ANGAZHIMI I MEKANIZMAVE
INSTITUCIONALË DHE STRUKTURAVE
PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E
FËMIJËS DHE I ORGANIZATAVE
JOFITIMPRURËSE

1. Bashkëpunimi ndërmjet mekanizmave këshillimorë e koordinues institucionalë, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror e vendor dhe organizatave jofitimprurëse për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe ofrimi i shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës, bëhet në bazë të rregullave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Mekanizmat institucionalë, strukturat për të drejtat e mbrojtjen e fëmijës dhe organizatat jofitimprurëse bashkëpunojnë, me qëllim:

a) Hartimin, zbatimin dhe monitorimin e ligjeve, të strategjive kombëtare, planeve të veprimit, kombëtare apo vendore, programeve dhe projekteve që kanë në fokus fëmijët, realizimin dhe respektimin e të drejtave të tyre, mbrojtjen, si dhe ofrimin e shërbimeve për ta;

b) Ngritjen dhe koordinimin e shërbimeve sociale, rehabilituese, riintegruese e ligjore për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe të fëmijëve të tjerë vulnerabël, me fokus të veçantë parandalimin;

c) Gjenerimin e të dhënave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet analizave, studimeve e vrojtimeve apo kërkimeve shkencore, të kryera në nivel qendror dhe vendor, për aspekte të ndryshme të jetës së fëmijës dhe kategorive të tyre;

ç) Ngritjen e strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor;

d) Mirëfunksionimin e mekanizmave institucionalë lokalë për mbrojtjen e fëmijës dhe menaxhimin efektiv të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

dh) Përf forcimin e kapaciteteve të profesionistëve të strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, si dhe të mekanizmave institucionalë, puna e të cilëve lidhet me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;

e) Promovimin dhe realizimin e mekanizmave efektivë për pjesëmarrjen e fëmijëve në të gjitha

proceset që ndikojnë në të drejtat dhe mirëqenien e tyre;

ë) Sensibilizimin e publikut, të profesionistëve dhe fëmijëve për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve.

3. Mekanizmat institucionalë dhe strukturat për të drejtat e mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror e vendor, në kuadër të këtij bashkëpunimi, angazhohen:

a) Të lehtësojnë procesin e koordinimit ndërmjet organizatave jofitimprurëse me institucionet shtetërore në nivel qendror e vendor, për realizimin e projekteve dhe programeve të përbashkëta në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, me fokus të veçantë fëmijët dhe grupet vulnerabël;

b) Të orientojnë dhe të koordinojnë nismat e ndërmarra nga organizatat jofitimprurëse me iniciativa të tjera, në kuadër të zbatimit të dokumenteve strategjike kombëtare me fokus fëmijët ose të programeve të tjera;

c) Të koordinojnë dhe harmonizojnë përpjekjet institucionale dhe të organizatave jofitimprurëse në veprimtaritë dhe shërbimet e munguara ose që nuk plotësohen nga institucionet shtetërore;

ç) Të nxisin dhe të krijojnë mundësi efektive të bashkëpunimit, duke përfshirë ato për pjesëmarrjen e fëmijëve;

d) Të zhvillojnë dhe të zbatojnë kritere e procese transparente për angazhimin dhe konsultimin me organizatat jofitimprurëse në procese të ndryshme, sipas kapaciteteve dhe mandatit të tyre;

dh) Të marrin pjesë në takime të rregullta konsultative, trajnime, konferenca dhe aktivitete të tjera të planifikuara për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;

e) Të ndajnë informacione dhe të dhëna që disponojnë mbi situatën e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e fëmijës;

ë) Të mbështesin organizatat jofitimprurëse, nëpërmjet orientimit të donatorëve vendës e ndërkombëtarë, për zbatimin në nivel vendor të objektivave të dokumenteve strategjike kombëtare me fokus fëmijët apo për plotësimin e shërbimeve, të programeve ose nevojave të tjera në përgjithësi, me qëllim ngritjen dhe funksionimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor;

f) Të ndërgjegjësojnë komunitetin në lidhje me çështje të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, duke



organizuar takime informuese, edukuese e trajnuese në territorin e bashkisë/komunës/qarkut;

g) Të mbështesin dhe të marrin përsipër menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, të referuara nga organizatat jofitimprurëse, pas identifikimit dhe vlerësimit të nevojave për shërbime, ndërhyrje apo masa mbrojtjeje;

gj) Të mbështesin, kur është e mundur, financimin e shërbimeve e të nismave të organizatave jofitimprurëse në mbështetje të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

h) Të nxisin monitorimin e pavarur të organizatave jofitimprurëse, duke respektuar dhe synuar interesin më të lartë të fëmijës.

4. Organizatat jofitimprurëse, sipas legjislacionit në fuqi në kuadër të këtij bashkëpunimi, angazhohen:

a) Të mbështesin dhe të bashkëpunojnë me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor, për zbatimin e programeve dhe projekteve, duke mbështetur fëmijët apo grupet e fëmijëve në situata rreziku, dhune, abuzimi, shfrytëzimi apo neglizhimi ose rreziku të përjashtimit social, me fokus të veçantë parandalimin;

b) Të ndajnë me institucionet shtetërore në nivel vendor praktikat më të mira dhe ekspertizën e tyre në drejtim të krijimit të shërbimeve parandaluese apo reaguese të mbrojtjes së fëmijës;

c) Të marrin pjesë aktivisht në proceset e diskutimeve e të konsultimeve për standardet, politikat, legjislacionin që lidhet me mbrojtjen e fëmijëve në shërbimet sociale, shëndetësore, arsimore, ligjore dhe shërbime të tjera;

ç) Të zbatojnë qasje që bazohen mbi të drejtat e fëmijës dhe mbi barazinë gjinore, si dhe të respektojnë standardet etike në proceset e planifikimit e zbatimit të programeve dhe projekteve të tyre;

d) Të marrin pjesë në veprimtarinë e grupeve teknike ndërsektoriale për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, duke përfshirë vlerësimin, hartimin dhe zbatimin e planit individual të mbrojtjes;

dh) Të kontribuojnë në vlerësimet për nevojat sociale të komuniteteve rurale, ndërrurbane dhe urbane, duke përfshirë në vlerësim ekspertë dhe duke lehtësuar procesin e vlerësimit nëpërmjet vrojtimeve, grupeve të fokusuar apo intervistave;

e) Të ndihmojnë në ngritjen e shërbimeve

komunitare alternative, të emergjencës apo shërbime të tjera të nevojshme për fëmijët vulnerabël dhe për fëmijët në nevojë për mbrojtje, si dhe në angazhimin e komuniteteve në procesin e vlerësimit të nevojave, planifikimit dhe zbatimit;

ë) Të ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve e të strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror e vendor;

f) Të dokumentojnë dhe të ndajnë informacione me strukturat e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, në lidhje me mbështetjen e ofruar gjatë menaxhimit të rasteve;

g) Të kryejnë monitorime mbi situatën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës në vend, të realizojnë raporte dhe të bëjnë publike gjetjet, duke respektuar parimin e interesit më të lartë të fëmijës.

KREU II

BASHKËPUNIMI NDËRMJET AGJENCISË SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS DHE ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

5. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, përveç fushave të bashkëpunimit, të parashikuara në pikën 1, të kreut I, bashkëpunon me organizatat jofitimprurëse në fushat si:

a) Koordinimi i punës me organizatat jofitimprurëse, që punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, me qëllim orientimin e duhur dhe shmangien e mbivendosjeve të projekteve, programeve e burimeve financiare dhe/ose njerëzore;

b) Zbatimi i ligjit dhe formalizimi i ndihmës së ndërsjellë për realizimin e detyrimeve ligjore të saj;

c) Zbatimi i modeleve dhe praktikave të reja, duke zbatuar projekte e programe të përbashkëta pilot;

ç) Konsultimi i iniciativave të reja, në kuadër të zbatimit të ligjit, me organizatat jofitimprurëse, që kanë ekspertizë në fusha të ndryshme të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës;

d) Shkëmbimi i informacionit të ndërsjellë me organizatat jofitimprurëse dhe informimi i tyre, në veçanti, për përditësimin e legjislacionit që rregullon mbrojtjen e fëmijës, kapacitetet dhe shërbimet e ofruara, si dhe çdo informacion tjetër të prodhuar nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, që nuk përbën sekret.



6. Organizatat jofitimprurëse informojnë Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në mënyrë periodike, të paktën një herë në vit, për:

a) Gjendjen e respektimit dhe të të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjes së tyre, problematikat e reja lidhur me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, bazuar në studimet apo çdo lloj tjetër iniciative të ndërmarrë, duke dërguar të dhëna apo çdo lloj informacioni tjetër;

b) Projektet, programet në fushën e të drejtave të fëmijës dhe të mbrojtjes së tij, rezultatet e arritura, hapat e ndërmarrë, kontributin, si edhe përfituesit e tyre;

c) Fëmijët që janë asistuar, shërbimet e ofruara, problematikat e hasura, me qëllim që Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës të përditësojë informacionin në Regjistrin Elektronik Kombëtar dhe të ndërmarrë nisma për të përmirësuar situatën.

KREU III FORMAT E BASHKËPUNIMIT

7. Bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, mekanizmeve institucionale dhe strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel qendror e vendor me organizatat jofitimprurëse realizohet duke synuar ndihmën dhe angazhimin e ndërsjellë, me qëllim promovimin dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së tyre.

8. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijës në nivel qendror e vendor krijojnë dhe mirëmbajnë instrumente, të cilat lehtësojnë bashkëpunimin e ndërsjellë, por pa u kufizuar në, si më poshtë vijon:

a) Ngritjen e bazave të të dhënave me informacionin e organizatave jofitimprurëse në nivel kombëtar e lokal;

b) Hartëzimin e shërbimeve të ofruara nga organizatat jofitimprurëse në nivel lokal;

c) Listimin e organizatave jofitimprurëse, të profesionistëve apo grupeve të profesionistëve të tyre, të cilët mund të angazhohen e të kontraktohen në lidhje me trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët në nevojë për mbrojtje.

9. Mekanizmat institucionale në nivel qendror e vendor, institucionet qendrore e vendore në nivel lokal hartojnë dhe zbatojnë marrëveshje

bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse në fushat e parashikuara në kreun I të këtij vendimi.

10. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, përveç formave të bashkëpunimit të parashikuara në pikën 7 të këtij vendimi, mund të bashkëpunojë me organizatat jofitimprurëse nëpërmjet:

a) Ngritjes së grupeve teknike, me përfaqësues të organizatave jofitimprurëse, për çështje të caktuara, që lidhen me zbatimin e ligjit ose të dokumenteve strategjike apo çdo çështje tjetër, e cila kërkon angazhimin e ekspertëve të organizatave jofitimprurëse dhe sjelljen e praktikave më të mira nga projektet apo programet e tyre;

b) Ngritjes së grupeve të punës të përbashkëta, me qëllim realizimin e ndërhyrjeve në situata të caktuara apo në raste të caktuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

c) Krijimit të bordeve këshillimore, me qëllim mbështetjen e Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, të komiteteve teknike të tij, mekanizmeve institucionale apo strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor.

11. Vendimi nr. 263, datë 12.4.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për bashkëpunimin midis mekanizmeve institucionale dhe organizatave jofitimprurëse për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, shfuqizohet.

12. Ngarkohen mekanizmat këshillimorë e koordinues institucionale dhe strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror e vendor, sipas pikave 2, 3 dhe 4, të nenit 34, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, dhe organizatat jofitimprurëse për zbatimin e këtij vendimi.

13. Ngarkohet ministri përgjegjës për bashkërendimin e çështjeve të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 149, datë 13.3.2018****PËR KRITERET, DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR EVIDENTIMIN E FAMILJES KUJDESTARE PËR FËMIJËT PA KUJDES PRINDËROR DHE MASËS SË FINANCIMIT PËR SHPENZIMET E FËMIJËS SË VENDOSUR NË FAMILJË KUJDESTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 24, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim përcakton:

a) Kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror;

b) Masën e financimit për fëmijën e vendosur në familje kujdestare.

2. Shërbimi i përkujdesjes alternative për fëmijë në familje kujdestare përfshin:

a) Identifikimin e familjes kujdestare;

b) Informimin dhe trajnimin e familjes kujdestare;

c) Vlerësimin e familjes kujdestare, të fëmijës që do të vendoset në familjen kujdestare dhe të familjes së tij biologjike;

ç) Vendimarrjen për familjen kujdestare dhe vendosjen e fëmijës në një familje kujdestare;

d) Monitorimin e fëmijës dhe të familjes kujdestare gjatë periudhës që është vendosur në këtë shërbim.

3. Struktura përgjegjëse për shërbimin e kujdesit alternativ për fëmijë në familje kujdestare (në vijim “struktura përgjegjëse”) është:

a) Struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashkinë ku banon fëmija;

b) Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit në njësinë administrative të bashkisë, ku banon fëmija;

c) Subjekti publik ose jopublik, ofrues i shërbimeve të kujdesit shoqëror ku është vendosur përkohësisht fëmija; apo

ç) Organizatat jofitimprurëse që ushtrojnë aktivitet në fushën e shërbimeve të përkujdesjes alternative për fëmijë.

II. KRITERET, PROCEDURAT DHE DOKUMENTACIONI PËR EVIDENTIMIN E FAMILJES KUJDESTARE

4. Bashkia është përgjegjëse për evidentimin e familjeve të gatshme për të qenë familje kujdestare në territorin e bashkisë përkatëse, në zbatim të Kodit të Familjes.

5. Për t’u përcaktuar si familje e gatshme për të qenë familje kujdestare, një familje duhet të plotësojë këto kritere:

a) Të ketë shfaqur interesin për të ofruar shërbimin e përkujdesjes alternative;

b) Anëtarët e familjes të jenë të motivuar për të qenë familje kujdestare;

c) Anëtarët e familjes të mos kenë qenë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë nga gjykata;

ç) Prindërit kujdestarë të kenë aftësi për të kryer detyrën e kujdestarit;

d) Prindërit kujdestarë dhe të gjithë anëtarët e familjes të vërtetojnë me raport mjekësor nga komisioni mjekoligjor që janë të aftë për të ofruar këtë shërbim dhe se nuk mbartin sëmundje të transmetueshme;

dh) Të strehojnë dhe të garantojnë mjedis familjar të sigurt për fëmijën;

e) Anëtarët e familjes të mos kenë qëndrime diskriminuese ndaj fëmijëve, fëmijëve me aftësi të kufizuara apo fëmijëve që i përkasin një minoriteti të caktuar;

ë) Të respektojnë ushtrimin e besimit fetar të fëmijës/fëmijëve apo të gjitha gjendjet e fëmijës sipas njërës apo disa prej shkaqeve të parashikuara në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi;

f) Prindërit kujdestarë të kenë kuptim të qartë dhe të jenë të gatshëm të zbatojnë parimin e veprimit, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës;

g) Prindërit kujdestarë të jenë të gatshëm për të bashkëpunuar me familjen biologjike të fëmijës dhe me strukturën përgjegjëse për shërbimin e kujdesit alternativ;

gj) Prindërit kujdestarë nuk kanë humbur, nuk u është hequr përgjegjësia prindërore ose nuk u është hequr detyra e kujdestarit në një rast tjetër;

h) Prindërit kujdestarë të jenë nën moshën 65 vjeç;



i) Prindërit kujdestarë të ushtrojnë përgjegjësinë prindërore në jo më shumë se tre fëmijë.

6. Çdo familje e interesuar për të qenë familje kujdestare duhet të shprehë interesin, duke paraqitur një kërkesë pranë strukturës përgjegjëse. Kërkesa përmban informacion për familjen sipas formularit nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Kërkesës i bashkëlidhet/n dokumenti/et e identifikimit të prindërve të familjes.

7. Punonjësi social i strukturës përgjegjëse (në vijim “punonjësi social përgjegjës”) bën vlerësimin paraprak të familjeve të interesuara, në bazë të kriterëve të vlerësimit të parashikuara në pikën 5, të këtij vendimi, dhe fton familjet e përzgjedhura të ndjekin seksionin e informimit mbi shërbimin e kujdestarisë.

8. Seksioni informues konsiston në dhënien e informacionit të hollësishëm për përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet e familjes kujdestare.

9. Në përfundim të seksionit informues, punonjësi social përgjegjës fton familjen kujdestare të konfirmojë me shkrim interesin për të vijuar me procedurën e regjistrimit si familje kujdestare.

10. Prindërit kujdestarë të interesuar ftohen nga punonjësi social përgjegjës dhe zhvillojnë një intervistë të strukturuar sipas formularit nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Intervista synon të marrë informacion të detajuar mbi kontekstin familjar, edukativ dhe social të familjes aplikuese, si dhe të kushteve e të mundësive që ka familja për të krijuar një mjedis të përshtatshëm familjar për mirërritjen e fëmijës.

11. Familjes së interesuar i kërkohet të paraqesë pranë punonjësit social përgjegjës këto dokumente plotësuese:

a) Raportin mjekoligjor, që vërteton se prindërit e familjes janë të aftë fizikisht dhe mendërisht;

b) Referencat për familjen nga 2 persona (njëri prej të cilëve duhet të jetë një përfaqësues i komunitetit në të cilin jeton familja).

12. Punonjësi social përgjegjës mbledh informacion shtesë të nevojshëm dhe siguron dokumentet e mëposhtme, nëpërmjet portalit unik *e-Albania*, mbi familjen e interesuar:

a) Përbërjen familjare aktuale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC) i vitit 2010;

b) Vërtetimin e gjendjes gjyqësore për anëtarët e familjes mbi 18 vjeç;

c) Të ardhurat e familjes;

ç) Pasuritë e paluajtshme të familjes;

d) Vërtetim nga strukturat e policisë, nëse ka pasur denoncime për dhunë në familje apo probleme të tjera me komunitetin;

dh) Verifikim social-ekonomik i familjes nga administratori shoqëror i njësish administrative.

13. Dokumentet e parashikuara në pikën 12 të këtij vendimi mblidhen nga punonjësi social përgjegjës nëpërmjet paraqitjes së kërkesës në institucionet respektive ose nëpërmjet aksesit në portalin elektronik për llogari të personave fizikë, sipas legjislacionit në fuqi.

14. Pas plotësimit të dokumentacionit, punonjësi social përgjegjës, në bashkëpunim me psikologun, kryen vlerësimin e mëtejshëm të familjes kujdestare të interesuar. Për kryerjen e vlerësimit, punonjësi social përgjegjës dhe psikologu mbështeten te të dhënat e mbledhura sipas pikave 10, 11 dhe 12 të këtij vendimi, si dhe informacionet që marrin nga:

a) Vizitat në banesën e aplikantit për të verifikuar kushtet e jetesës së familjes kërkuese;

b) Takimet individuale dhe në grup me të gjithë anëtarët e familjes së aplikantit;

c) Intervistat e personave të paraqitur nga aplikanti, si referencë;

ç) Intervistat e specialistëve të tjerë, si: psikologë, punonjës të policisë, përfaqësues të organeve të pushtetit vendor në vendbanimin e familjes kërkuese, punëdhënësin e bashkëshortit/es, përfaqësues të institucioneve arsimore, përfaqësues të komunitetit.

15. Nëse, sipas vlerësimit, gjykohet se familja është e përshtatshme për të qenë familje kujdestare, prindërit kujdestarë të interesuar i nënshtrohen trajnimit për prindër kujdestarë, të organizuar nga struktura përgjegjëse dhe gjatë këtij procesi vlerësohen kapacitetet, aftësitë dhe shprehitë e tyre si prind kujdestar. Kryerja e trajnimit dokumentohet me një procesverbal ose me certifikatën e trajnimit.

16. Pas përfundimit të trajnimit, punonjësi social përgjegjës dhe psikologu përgatisin raportin e vlerësimit të familjes kujdestare.

17. Dokumentet e mbledhura sipas pikave 6, 7, 10, 11, 12, 14, 15 dhe 16 të këtij vendimi sistemohen nga punonjësi social përgjegjës në dosjen e familjes kujdestare të interesuar dhe dërgohen nga struktura përgjegjëse për vendim-



marrje në komisionin multidisiplinar në bashkinë përkatëse.

18. Komisioni multidisiplinar mbledhet për të shqyrtuar rastin, bën vlerësimin nëse familja plotëson ose jo kushtet për të ofruar shërbimin e kujdestarisë në familje, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur dhe merr vendimin për miratimin e familjes kujdestare brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së dosjes, sipas pikës 17 të këtij vendimi.

19. Vendimi i komisionit multidisiplinar i përcillet strukturës përgjegjëse që ka paraqitur dokumentacionin pranë saj, si dhe strukturës së shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit në njësinë administrative ku banon familja kujdestare.

20. Struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki regjistron familjen në regjistrin e familjeve kujdestare që ngre dhe administron.

III. PROCEDURA E VENDOSJES SË FËMIJËS PA KUJDES PRINDËROR NË FAMILJEN KUJDESTARE

21. Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, në rastet e emergjencës, vepron në mënyrë të menjëhershme, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, dhe në ligjin nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, duke siguruar shërbim përkujdesjeje të menjëhershme.

22. Pas sigurimit të përkujdesjes së menjëhershme, sipas pikës 21 të këtij vendimi, njësia e mbrojtjes të fëmijëve i referon rastin strukturës përgjegjëse të bashkisë, ku ka vendbanimin fëmija.

23. Struktura përgjegjëse, me marrjen e referimit, sipas pikës 22, të këtij vendimi, mbledh të dhënat për fëmijën pa kujdes prindëror dhe familjen biologjike të tij. Informacioni mbledhet dhe evidentohet, sipas formularit nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

24. Në përfundim të procesit të mbledhjes së informacionit, punonjësi social përgjegjës harton raportin e vlerësimit të rastit, i cili përfshin vlerësimin e fëmijës pa kujdes prindëror dhe vlerësimin e familjes së tij biologjike dhe përmban këto informacione:

- a) Përbërësit e gjendjes civile individuale dhe familjare të fëmijës;
 - b) Marrëdhëniet familjare dhe sociale të fëmijës;
 - c) Gjendjen shëndetësore të fëmijës;
 - ç) Nivelin e arsimit të fëmijës;
 - d) Temperamentin dhe interesat e shfaqur të fëmijës;
 - dh) Nevoja të veçanta, probleme të shfaqura të fëmijës;
 - e) Arsytet për të cilat fëmija duhet të vendoset në shërbim kujdestarie;
 - ë) Moshën e prindërve biologjikë;
 - f) Vendbanimin e prindërve biologjikë;
 - g) Punësimin dhe të ardhurat financiare të prindërve biologjikë;
 - gj) Nivelin e arsimit të pjesëtarëve të familjes biologjike;
 - h) Kushtet e strehimit të familjes biologjike;
 - i) Gjendjen shëndetësore të anëtarëve të familjes biologjike;
 - j) Gjendjen psikosociale dhe ligjore të pjesëtarëve të familjes biologjike;
 - k) Deklaratën e prindit/prindërve biologjikë kur prindi/prindërit jetojnë, në të cilën shprehet aprovimi për vendosjen e fëmijës në familje kujdestare, me përjashtim të rasteve kur për fëmijën është marrë një nga masat e mbrojtjes, të parashikuara në nenin 55, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.
25. Punonjësi social përgjegjës plotëson dosjen e fëmijës, duke mbledhur informacion shtesë të nevojshëm dhe siguron dokumentet e mëposhtme, nëpërmjet portalit unik *e-Albania*:
- a) certifikatën personale të fëmijës me fotografi;
 - b) 4 fotografi të fëmijës;
 - c) certifikatën familjare të fëmijës;
 - ç) raportin mjekoligjor për gjendjen shëndetësore dhe mendore të fëmijës;
 - d) kopjen e fletores së fëmijës për vaksinimet e kryera;
 - dh) dëftesën shkolllore për fëmijën, nëse fëmija frekuenton një të tillë;
 - e) vërtetimin nga institucioni i përkujdesjes shoqërore, nëse fëmija është vendosur në një të tillë.
26. Plotësimi i dosjes, përveç parashikimit në shkronjën “b”, të pikës 25, të këtij vendimi, sigurohet nëpërmjet kërimit të dokumentacionit në institucionet respektive ose nëpërmjet aksesit në portalin elektronik, për llogari të personave fizikë, sipas legjislationit në fuqi.



27. Punonjësi social përgjegjës informon fëmijën për mundësinë e vendosjes në një familje kujdestare, i merr atij mendim mbi preferencat e tij për familjen e ardhshme kujdestare. Mendimi i fëmijës merret:

a) Në mënyrë verbale, në prani të tij, për fëmijën nga mosha 6–10 vjeç;

b) Me shkrim, në prani të tij, për fëmijën mbi 10 vjeç.

28. Dosja e rastit, që përfshin dokumentet e mbledhura sipas pikave 23, 24, 25 dhe 27 të këtij vendimi, i dërgohet, nga struktura përgjegjëse, komisionit multidisiplinar të kujdestarisë në bashkinë që ka bërë referimin, brenda një afati 15-ditor nga momenti i referimit.

29. Komisioni multidisiplinar, brenda një jave nga paraqitja e dosjes, sipas pikës 28 të këtij vendimi, përzgjedh dhe propozon një nga familjet kujdestare nga regjistri i familjeve kujdestare, krijuar sipas pikës 20 të këtij vendimi.

30. Komisioni multidisiplinar përzgjedh familjen kujdestare, sipas pikës 29 të këtij vendimi, duke gjykuar mbi përshtatshmërinë sa më të mirë të nevojave të fëmijës me familjen që propozohet si familje kujdestare. Përshtatshmëria ndërmjet familjes kujdestare dhe fëmijës bazohet në vlerësimin e zhvillimit të personalitetit të fëmijës, në kontekstin familjar edukativ e social dhe vlerësimin e kushteve dhe të përshtatshmërisë së fëmijës me familjen kujdestare të ardhshme, si dhe në kriteret e mëposhtme:

a) Për fëmijën: mosha, temperamenti, interesat, marrëdhëniet me fëmijët e tjerë dhe nevoja të veçanta që mund të ketë;

b) Për familjen biologjike: mosha, temperamenti, profesioni/punësimi, strehimi, interesat, niveli i edukimit;

c) Për familjen kujdestare: mosha, temperamenti, punësimi/profesioni, aftësitë, interesat, niveli edukativ, qëndrimet kundrejt kulturave të tjera, statusi ligjor, kompetencat profesionale, preferencat ndaj fëmijëve potencialë për shërbim kujdestarie, gatishmëria, banimi (distanca nga familja biologjike), fëmijët e tjerë të familjes.

31. Me marrjen e njoftimit nga komisioni multidisiplinar, sipas pikës 30 të këtij vendimi, struktura përgjegjëse njofton familjen kujdestare për vendimin që ka marrë për përzgjedhjen si familje kujdestare dhe kjo e fundit i paraqet

deklaratën e gatishmërisë për të marrë fëmijën në përkujdesje.

32. Struktura përgjegjëse paraqet kërkesën në gjykatë, sipas nenit 264 të Kodit të Familjes.

33. Gjykata vendos, sipas dispozitave të Kodit të Familjes, për vendosjen e fëmijës në një familje kujdestare.

34. Struktura përgjegjëse, që ka ndjekur procedurën përkatëse në gjykatë, depoziton një kopje të vendimit të gjykatës pranë njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit ku banon familja kujdestare.

35. Me marrjen e vendimit, sipas pikës 34 të këtij vendimi, punonjësi social përgjegjës bën përgatitjen paraprake të fëmijës, që përfshin:

a) Informimin e fëmijës (bazuar në nivelin e të kuptuarit dhe moshën);

b) Përshtatjen graduale të fëmijës me familjen kujdestare, nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta të fëmijës me familjen kujdestare, vizitave dhe takimeve, numri i të cilave përcaktohet dhe realizohet rast pas rasti dhe është i kushtëzuar nga ritmi individual i përshtatjes së çdo fëmije;

c) Sistemimin e fëmijës në familjen kujdestare;

ç) Hartimin e një plani individual për fëmijën;

d) Hartimin e një plani për fuqizimin e familjes biologjike, për mundësimin e rikthimit të fëmijës.

IV. MONITORIMI I FËMIJËS DHE I FAMILJES KUJDESTARE

36. Njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit ose struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror, për bashkitë që nuk kanë njësi të vlerësimit dhe referimit të rastit, monitoron në vazhdimësi familjen dhe fëmijën e vendosur në kujdestari, nëpërmjet kryerjes së vizitave të monitorimit në shtëpi apo gjatë veprimtarisë normale të familjes.

37. Vizitat e monitorimit, sipas pikës 36 të këtij vendimi, bëhen çdo 2 javë në 3 muajt e parë për familjen dhe fëmijën e vendosur në kujdestari dhe, më pas, çdo muaj. Rezultatet e çdo vizite dokumentohen dhe përfshihen në dosjen përkatëse të fëmijës.

38. Drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror monitorojnë çdo 3 muaj proceset e punës së punonjësit social të njësisë së qeverisjes vendore dhe bëjnë monitorimin e fëmijëve të vendosur në familje kujdestare.



39. Inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale inspekton 2 herë në vit familjen kujdestare dhe fëmijën, për të siguruar respektimin e standardeve të shërbimit të kujdestarisë, si dhe për të siguruar mirëqenien e fëmijës, sipas procedurave për zbatimin e standardeve të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

40. Monitorimi nga drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe inspektimi nga inspektorati përgjegjës për shërbimet shoqërore koordinohen dhe realizohen në ditët e monitorimit të familjes nga struktura e shërbimeve të kujdesit shoqëror të bashkisë ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit të njësisë administrative.

41. Në rastet kur punonjësit e strukturave monitoruese apo inspektuese, informohen ose besojnë në mënyrë të arsyeshme se fëmija ndodhet në situatë emergjence, procedojnë menjëherë, duke referuar rastin të njësitë e mbrojtjes së fëmijës, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, dhe në ligjin nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

V. MASA E FINANCIMIT PËR SHËRBIMIN

42. Masa e financimit për familjen kujdestare, për shpenzimet ushqimore për një fëmijë të vendosur në kujdestari, është 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj, ndërsa për shpenzimet e ushqimit të një fëmije me aftësi të kufizuara është 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

43. Masa e financimit për familjen kujdestare, për një fëmijë të vendosur në kujdestari, është si vijon:

a) shpenzime për veshmbathje: 10 000 (dhjetë mijë) lekë në vit;

b) shpenzime për shkollimin: 5 000 (pesë mijë) lekë në vit; dhe

c) shpenzime të tjera: 10 000 (dhjetë mijë) lekë në vit.

44. Pagesa e familjes kujdestare bëhet një herë në muaj, pranë njësisë administrative, ku ka vendbanimin e përhershëm familja kujdestare.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

45. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale, strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe e referimit të rastit për zbatimin e këtij vendimi.

46. Vendimi nr. 89, datë 26.1.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të procedurave të shërbimit të kujdestarisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

47. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, janë brenda fondeve të miratuara të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, planifikuar në programin buxhetor “Përkujdesja sociale”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



FORMULARI NR. 1.
MBI TË DHËNAT E APLIKUESIT

I- Të dhëna personale

- 1- Emri _____
- 2- Mbiemri _____
- 3- Mosha _____
- 4- Statusi civil _____
- 5- Adresa _____

II- Cili është burimi juaj i informacionit mbi shërbimin e kujdestarisë?**III- Cili është motivi që ju shtyn për t'u ofruar si prind kujdestar?****IV- Cilat janë marrëdhëniet tuaja me ligjin?**

- A ju është mohuar e drejta prindërore në ndonjë periudhë të jetës suaj? Nëse po, kur?
Po Jo _____
- A keni qenë ndonjëherë i ndjekur penalisht? Nëse po, kur? Po Jo _____

V- Sa janë të ardhurat mujore të familjes tuaj (përfshi të gjithë anëtarët e familjes)?
_____ lekë**VI- Jepni të dhëna për nivelin e edukimit tuaj.**

- I ulët
- I mesëm
- I lartë

VII- A keni pasur ndonjëherë apo keni ndonjë problem shëndetësor?**VIII- Sa është sipërfaqja e banesës suaj? _____ m²****IX- Sa fëmijë keni? Jepni moshën dhe seksin e tyre**

Emri

Mosha

Seksi

_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

X- A janë dakord të gjithë anëtarët e familjes suaj me vendimin për të qenë familje kujdestare? Po Jo

- Nëse jo, cili nga anëtarët dhe për çfarë arsyeje?

**FORMULAR NR. 2****ME TË DHËNA TË DETAJUARA TË FAMILJES KUJDESTARE**

(Ju lutem lexoni udhëzimin për plotësimin e rregullt të formularit)

I- DETAJE KONTAKTI

Institucioni/organizata/agjencia e cila ofron shërbimin e kujdestarisë:

Emri i punonjësit social: _____

Emri i menaxherit/drejtuesit: _____

Adresa: _____

Nr. tel./fax: _____

II- TË DHËNA PËR FAMILJEN KUJDESTARE**1. TË DHËNA PËR PRINDËRIT KUJDESTARË**

	Nëna	Babai
Emri	_____	_____
Mbiemri	_____	_____
Mbiemri i mëparshëm	_____	_____
Datëlindja	_____	_____
Shtetësia	_____	_____
Punësimi	_____	_____
Adresa	_____	_____
Nr. tel.	_____	_____

2. MARRËDHËNIET E FAMILJES KUJDESTARE ME LIGJIN

(Lexoni udhëzimin bashkëngjitur formularit)

	Nëna	Babai	
A e gëzoni aktualisht të drejtën prindërore?	PO JO	PO JO	Nëse jo, për çfarë arsyeje?
A ju është mohuar e drejta prindërore në ndonjë periudhë të jetës suaj?	PO JO	PO JO	Nëse po, për çfarë arsyeje?
A keni qenë ndonjëherë i ndjekur penalisht?	PO JO	PO JO	Nëse po, kur dhe për çfarë arsyeje?
A keni ndonjë anëtar të familjes të ndjekur penalisht?	PO JO	PO JO	Nëse po, kur dhe për çfarë arsyeje?

**3. STATUSI FINANCIAR**

Sa janë të ardhurat mujore të familjes suaj (duke përfshirë të gjithë anëtarët e saj)? _____ lekë

4. EDUKIMI

Jepni të dhëna mbi edukimin tuaj.

	Nëna	Babai
I ulët	☐	☐
I mesëm	☐	☐
I lartë	☐	☐

5- SHËNDETI

Përshkruani shkurtimisht gjendjen tuaj shëndetësore në të kaluarën dhe atë aktuale.

(Për gjendjen aktuale plotësoni formularin bashkëngjitur sipas udhëzimit të dhënë dhe merrni një raport nga mjeku psikiatër.)

6- STATUSI CIVIL

	Nëna	Babai
I /e martuar	☐	☐
I/e divorcuar	☐	☐
I/e ve	☐	☐
Beqar	☐	☐

7- MOTIVIMI

a- Cilat janë motivet që ju shtyjnë për të qenë familje kujdestare?

b- A janë dakord të gjithë anëtarët e familjes me vendimin për të qenë familje kujdestare?

	Po	Jo
Fëmijët	☐	☐
	☐	☐
	☐	☐
	☐	☐
Anëtarët e tjerë të familjes	☐	☐
	☐	☐
	☐	☐

c- A jeni të gatshëm të pranoni bashkëpunimin midis jush dhe familjes së origjinës në të mirë të fëmijës? Po Jo

d- A jeni të gatshëm për një bashkëpunim të ngushtë dhe të vazhdueshëm me agjencinë? Po Jo

**8- STREHIMI**

- a- Sa është sipërfaqja e banimit të shtëpisë tuaj? _____m²
- b- Jepni tipin e shtëpisë, sistemin e ujit dhe kanalizimeve.

9- KOMUNITETI

- a- Përshkruani karakteristikat tipike të komunitetit tuaj.

- b- Si janë marrëdhëniet tuaja me fqinjët?

- ☐ Shumë të mira
- ☐ Normale
- ☐ Jo të mira

- c- Çfarë institucioneve edukuese ju ofron komuniteti?

- ☐ Çerdhe
- ☐ Kopshte
- ☐ Shkollë fillore
- ☐ Shkollë tetëvjeçare
- ☐ Shkollë të mesme

- d- Çfarë institucioneve shëndetësore ju ofron komuniteti?

- ☐ Ambulancë
- ☐ Klinikë dentare
- ☐ Konsultore
- ☐ Qendër shëndetësore
- ☐ Spital

- e- Çfarë qendrash argëtimi ju ofron komuniteti?

- ☐ Sheshe për të luajtur
- ☐ Park lojërash
- ☐ Bibliotekë
- ☐ Kinema

- f- Me çfarë mjetesh realizohet transporti brenda dhe jashtë komunitetit tuaj?

- ☐ Autobus
- ☐ Fugon
- ☐ Tren

III. TË DHËNA PËR FËMIJËT E FAMILJES KUJDESTARE

Emri	Seksi	Datëlindja	Shkolla që frekuenton	Marrëdhënia me prindin
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____

**IV. TË DHËNA PËR ANËTARËT E TJERË TË FAMILJES**

Emri	Seksi	Datëlindja	Marrëdhënia brenda strukturës familjare
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____

V. PËRSHKRIMI I FAMILJES KUJDESTARE

Jepni një përshkrim të jetës suaj familjare (interesat, eksperiencat, si organizohet jeta brenda familjes, pikat e forta dhe të dobëta).

VI. REKOMANDIME

Jepni emrat dhe adresat e dy personave që ju njohin për më shumë se një vit dhe nuk kanë lidhje gjaku me ju.

Emër Mbiemër	Adresa	Nr. tel.
_____	_____	_____
_____	_____	_____

**APLIKANTI
EMËR MBIEMËR**

**PUNONJËSI SOCIAL
EMËR MBIEMËR**



FORMULARI NR. 3
TË DHËNAT E FËMIJËS QË DO TË VENDOSËT NË KUJDESTARI

I- DETAJE KONTAKTI

Institucioni/organizata/agjencia e cila ofron shërbimin e kujdestarisë:

Emri i punonjësit social: _____

Emri i menaxherit/drejtuesit: _____

Adresa: _____

Nr. tel./fax: _____

II- TË DHËNA IDENTIFIKUESE TË FËMIJËS

Emri _____

Mbiemri _____

Gjinia _____

Datëlindja _____

Vendlindja _____

Shtetësia _____

Adresa aktuale _____

Nr. tel. _____

III- STATUSI LIGJOR I FËMIJËS

☐ Nën kujdesin e familjes biologjike

☐ I deklaruar i braktisur

☐ Nën kujdesin e shtetit

☐ Nën kujdesin e familjes kujdestare

☐ Të tjera, specifiko _____

IV- MARRËDHËNIA E FËMIJËS ME FAMILJEN NË TË CILËN JETON AKTUALISHT

☐ Fëmijë nga martesë aktuale

☐ Fëmijë nga martesë e mëparshme

☐ Fëmijë i birësuar

☐ Fëmijë i vendosur nën kujdestari

☐ Tjetër (nëse po, specifiko) _____

V- PËRFITIMET E FËMIJËS NGA:

☐ Trashëgimia

☐ Pension familjar

☐ Pension i paaftësisë

☐ Sistemi i asistencës sociale

☐ Burime të tjera (specifiko) _____

VI- PËRSHKRIM I SHKURTËR I FËMIJËS

1. Zhvillimi psikomotor i fëmijës, emocional dhe social të tij.



2. Rutina ditore e fëmijës.

3. Sjellje të veçanta të fëmijës që mund të shkaktojnë shqetësime.

VII- PËRSHKRIM I SITUATËS SHËNDETËSORE

1. Probleme shëndetësore, aftësi të kufizuara, nëse ka, alergjitë, nevoja për dietë, mjekimet, vizitat mjekësore.

2. Historia mjekësore, imuniteti, sëmundje të së kaluarës, probleme të tjera (urinimi në krevat etj.).

3. Kontaktet me mjekun, dentistin, pediatrin etj.

VIII- EDUKIMI

1. Emri i shkollës _____

2. Adresa e shkollës _____

3. Lloji i shkollës

- ☐ Edukim parashkollor
- ☐ Shkollë fillore
- ☐ Nëntëvjeçare
- ☐ Nëntëvjeçare me konvikt
- ☐ E mesme
- ☐ E mesme me konvikt
- ☐ Shkollë për fëmijë me nevoja të veçanta



Renditni më poshtë shkollat e ndjekura më parë nga fëmija (nëse ka):

Emri i shkollës	Adresa	Lloji	Vitet/viti shkollor
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____

Kontaktet me edukatorët, mësuesit etj.

IX- VENDBANIMET E FËMIJËS QË NGA LINDJA

Paraqisni një listë të detajuar të të gjitha vendbanimeve të njohura për fëmijën, arsyet e lëvizjes dhe sistemin aktual të tij. Në fund të listës përshkruani shkurtimisht arsyet e lëvizjes së tij.

<i>Vendbanimet e fëmijës (fam. biologjike, kujdestare, institucione etj.)</i>	<i>Koha e qëndrimit</i>	<i>Mosha e fëmijës gjatë kësaj periudhe</i>	<i>Emrat e prindërve biologjikë, kujdestarëve, punonjësit social</i>	<i>Arsyet e lëvizjes</i>

X- MOTRAT DHE VËLLEZËRIT E FËMIJËS

Emri	Mbiemri	Seksi	Datëlindja	Lidhja e gjakut me fëmijën	Vendbanimi
_____	_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____	_____	_____

(Vendosni shenjë “X” për vëllain/motrën me të cilën fëmija është shumë i lidhur dhe shenjë “XX” për vëllain/motrën me të cilën fëmija kërkon të mbajë kontakte të vazhdueshme në të ardhmen.

- Jepni një përshkrim të shkurtër të takimeve aktuale dhe atyre të planifikuara me motrat dhe vëllezërit (nëse fëmija ka qëndruar më parë në familje kujdestare apo institucion).

**XI- FAMILJA BIOLOGJIKE**Nëna e fëmijës

Emri _____

Mbiemri _____

Mbiemri i mëparshëm _____

Datëlindja _____

Vendlindja _____

Emri i bashkëshortit _____

Adresa _____

Emrat e personave të tjerë në familje _____

A e gëzon të drejtën prindërore? Po Jo

- Jepni shkurtimisht një përshkrim të përgjithshëm për nënën e fëmijës.

- Cila është shkalla e lidhjes dhe kontakteve të nënës me fëmijën?

Babai i fëmijës

Emri _____

Mbiemri _____

Datëlindja _____

Vendlindja _____

Emri i bashkëshortes _____

Adresa _____

Emrat e personave të tjerë në familje _____

A e gëzon të drejtën prindërore? Po Jo

- Jepni shkurtimisht një përshkrim të përgjithshëm për babanë e fëmijës.

- Cila është shkalla e lidhjes dhe kontakteve të babait me fëmijën?



	Nëna biologjike	Babai biologjik
Niveli i edukimit	_____	_____
Punësimi aktual	_____	_____
Punësimi i mëparshëm	_____	_____
Statusi civil kur ka lindur fëmija	_____	_____
Statusi civil aktual	_____	_____
Kur e kanë ndërprerë kujdesin për fëmijën?	_____	_____
A ka secili prind përgjegjësi për fëmijën?	_____	_____

Raste të tjera:

a) Njerjë b) Nënë adoptive c) Nënë kujdestare

Emri _____
 Mbiemri _____
 Mbiemri i vajzërisë _____
 Datëlindja _____
 Vendlindja _____
 Emri i bashkëshortit _____
 Adresa _____
 Emrat e personave të tjerë në familje _____
 A e gëzon të drejtën prindërore? Po Jo

- Jepni shkurtimisht një përshkrim të përgjithshëm të saj.

- Cila është shkalla e lidhjes dhe kontakteve të saj me fëmijën?

a) Njerë b) Baba adoptiv c) Baba kujdestar

Emri _____
 Mbiemri _____
 Datëlindja _____
 Vendlindja _____
 Emri i bashkëshortes _____
 Adresa _____
 Emrat e personave të tjerë në familje _____
 A e gëzon të drejtën prindërore? Po Jo



- Jepni shkurtimisht një përshkrim të përgjithshëm për të.

- Cila është shkalla e lidhjes dhe kontakteve të tij me fëmijën?

	Nëna	Babai
Niveli i edukimit		
Punësimi aktual		
Punësimi i mëparshëm		
Statusi civil aktual		
Kur e kanë filluar kujdesin për fëmijën?		
Kur e kanë ndërprerë përkujdesjen për fëmijën?		
A ka secili prind përgjegjësi për fëmijën?		

- Jepni të dhëna për kujdestarin ligjor të fëmijës (nëse ka një të tillë).

XII- PRIORITETET QË KA FËMIJA PËR ZGJEDHJEN E FAMILJES KUJDESTARE

(nëse fëmija është mbi 10 vjeç)

- Shëndeti

- Edukimi

- Mosha

- Pozicioni gjeografik

- Ndonjë dëshirë tjetër e fëmijës

- A ka ndonjë konflikt interesash që duhet marrë parasysh në përzgjedhjen e familjes kujdestare?

Po Jo

Nëse po, shpjegoni

**VENDIM****Nr. 150, datë 13.3.2018**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 431, DATË 8.6.2016, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË
DOKUMENTACIONIT, PROCEDURAVE
DHE TË MASËS PËR PËRFITIMIN E
PAGESËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR E
TË NDIHMËSIT PERSONAL, DHE TË
STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE E TË
DETYRAVE TË TYRE
NË ZONAT PILOT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 42/3, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim emërtimi “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë” zëvendësohet me “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”.

2. Në pikën 1, të kreut I, fjalët “... për një periudhë 6-mujore ...” zëvendësohen me “... deri më 31.12.2019 ...”.

3. Në shkronjën “c”, të pikës 2, të kreut II, pas emërimit “Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor (QKSHM)” shtohet “/Qendra Kombëtare e Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve (QKMZHRF)”.

4. Në kreun IV bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Fjalja e dytë e pikës 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar indekskohet sa herë indekskohet pensioni social.”.

b) Në shkronjën “c”, fjalët “... kufizime të thella ...” zëvendësohen me “... kufizime të rënda...”.

c) Në shkronjën “ç”, fjalët “... kufizime të rënda ...” zëvendësohen me “... kufizime të thella...”.

ç) Në shkronjën “a”, të pikës 5, fjalët “... raportin vjetor mjekësor ...” zëvendësohen me “... formularin vjetor mjekësor të plotësuar nga mjeku specialist ...”.

d) Në shkronjën “c”, të pikës 10, fjalët “... pas periudhës 2-vjeçare të punësimit ...” zëvendësohen me “... pas 48 muajve të punësimit ...”.

dh) Pika 13 ndryshohet si më poshtë vijon:

“13. Shërbimi i ndihmës personal ofrohet nga individë të cilët kanë vendbanimin në Shqipëri, brenda së njëjtës bashki me personin me aftësi të kufizuara, kanë aftësi mendore dhe fizike për të ofruar këto shërbime dhe nuk janë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë.”.

e) Në pikën 14, pas fjalëve “... përmes një kontrate ...” shtohen “... ose deklarate ...”.

5. Në fund të pikës 2, të kreut V, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Shërbimi Social Shtetëror ngre komisionin e shqyrtimit të ankesave, i cili funksionon në bazë të rregullores së miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet sociale.”.

6. Pika 1 e kreut VI ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Nuk i nënshtrohen procedurës së vlerësimit në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi:

a) përfituesit ekzistues sipas vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të cilët janë të verbër, invalidë pune, si edhe të verbrit të cilëve u ka lindur e drejta për t’u trajtuar me pension pleqërie/social, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) aplikuesit për herë të parë të moshës 0 deri në 2 vjeç, që kërkojnë të vlerësohen sipas vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar;

c) aplikuesit për herë të parë që kërkojnë të vlerësohen sipas vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të cilëve u ka lindur e drejta për t’u trajtuar me pension pleqërie/social, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

ç) përfituesit ekzistues sipas pikave 1 e 2, të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara”, të ndryshuar, të cilëve u ka lindur e drejta për t’u trajtuar me pension pleqërie/social, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;



d) aplikuesit për herë të parë të moshës 0 deri në 2 vjeç, që kërkojnë të vlerësohen sipas pikave 1 e 2, të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara”, të ndryshuar;

dh) aplikuesit për herë të parë që kërkojnë të vlerësohen sipas pikës 2, të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara”, të ndryshuar, të cilëve u ka lindur e drejta për t’u trajtuar me pension pleqërie/social, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

e) përfituesit ekzistues sipas pikës 1, të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik e tetraplegjik”, të ndryshuar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM Nr. 132, datë 16.2.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 21.5.2015, “MBI PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE, PROCEDURAVE DHE AFATEVE TË VLEFISHMËRISË SË LICENCAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT NDËRKOMBËTAR DETAR PËR AUTOMJETE DHE/OSE UDHËTARË DHE SHKAQET E PROCEDURAT E PEZULLIMIT APO TË REVOKIMIT TË TYRE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 18, të ligjit nr. 10109, datë 2.4.2009, “Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo

nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”; të ligjit nr. 9852, datë 26.12.2007, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në memorandumin e mirëkuptimit për kontrollin shtetëror portual”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 4, datë 21.5.2015, “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre”, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2 “Përkufizimi”, pas pikës 13 shtohen pikat 14 dhe 15 me këtë përmbajtje:

“14. “Kontrolli Shtetëror i Flamurit (KSHF)” është strukturë në përbërje të administratës detare dhe ushtron veprimtarinë për inspektimin e certifikimin e sigurisë teknike të mjeteve lundruese, që mbajnë flamurin shqiptar;

15. “Kontrolli Shtetëror Portual (KSHP)” është strukture e veçantë, që funksionon në kapitanerinë e porteve për kontrollin shtetëror portual në mjetet lundruese të huaja.”.

Neni 2

Në nenin 9 “Vërtetimi për kushtet teknike të anijes”, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Inspektimet do të kryhen nga Kontrolli Shtetëror i Flamurit në përputhje me ligjin nr. 10109, datë 2.4.2009, “Për administratën detare të RSH-së” dhe Kontrolli Shtetëror Portual në përputhje me VKM-në nr. 13, datë 11.1.2017, “Për miratimin e rregullores për Kontrollin Shtetëror Portual në RSH”. Inspektimi do të kryhet në rastin e parë që anija prek portin/terminalin portual dhe do të zgjasë jo më shumë se pesë ditë pa ndërprerë operimin e mjetit lundrues.”.

Neni 3

Në nenin 10, “Kontrata me portin/terminalin portual” bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:

1. Te paragrafi i parë, fjala “Pas ...” zëvendësohet me fjalën “Para ...”;



2. Te pika 3, pas fjalëve “operimit të ...” fjalët “mjetit lundrues” zëvendësohen me fjalët “mjetit/mjeteve lundrues/lundruese”;

3. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Deklarimin e operatorëve për respektimin e orareve në nisje/mbërritje nga/në portet nga mjeti/mjetet lundrues/lundruese objekt licencimi, si dhe të përgjegjësive monetare ndaj udhëtarëve/transportuesve për vonesa të pajustificuara nga autoritetet shtetërore, si policia kufitare dhe e migracionit, shërbimi doganor dhe kapitaneria e portit.”.

Neni 4

Në nenin 11, “Prekjet e anijes në port”, pika 2, pika 3 dhe pika 4, ndryshohen si më poshtë:

“2. Gjatë hartimit të grafikut nga porti/terminali portual, duhet të mbahen parasysh që prekjet të shpërndahen në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët dhe në mënyrë proporcionale gjatë gjithë muajit. Grafiku dhe çdo ndryshim i tij është pjesë përbërëse e dokumentacionit për miratimin e licencës së transportit ndërkombëtar detar të mallrave dhe të njerëzve dhe që miratohet nga organet përgjegjëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Operatorët të cilët operojnë në linjë ndërkombëtare detare dhe kanë prekje në portet përkatëse sipas grafikut të miratuar për linjë, çdo ditë të javës, duhet ta prekin atë port minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) herë në muaj. Ndërsa operatorët të cilët operojnë në linjat ndërkombëtare detare dhe kanë prekje në portet përkatëse sipas grafikut të miratuar për linjë, 5 (pesë) herë në javë e më pak, duhet ta prekin atë port minimalisht 4 (katër) herë në muaj;

4. Në rastet kur operatori i licencuar kërkon të kryejë riparim të anijes, duhet të jetë i pajisur me një leje të veçantë nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.”.

Neni 5

Në nenin 14, “Transporti detar turistik”, pas pikës 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Mjetet e përfshira në licencën për kryerjen e transportit ndërkombëtar detar për automjete dhe ose udhëtarë nuk mund të kryejnë udhëtime turistike pa zbatuar grafikun e miratuar ose pa u zëvendësuar me mjet tjetër.”.

Neni 6

Udhëzimi nr. 6251, datë 23.12.2016, “Për ndryshimin e udhëzimit nr. 4, datë 21.5.2015, “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo të revokimit të tyre”, shfuqizohet.

Neni 7

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjijnuri

VENDIM
Nr. 15, datë 12.3.2018

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE
NË FORMULARIN E
VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATIT
NGA LISTA SHUMEMËRORE PËR
ANËTARË NË KËSHILLIN E BASHKISË
LEZHË Z. SURI DAMZI, NË ZBATIM TË
LIGJIT NR. 138/2015,
“PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT
TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN,
EMËROHEN OSE USHTROJNË
FUNKSIONE PUBLIKE”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 12.3.2018, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri	kryetar
Denar Biba	zëvendëskryetar
Bledar Skënderi	anëtar
Edlira Jorgaqi	anëtare
Gëzim Veleshnja	anëtar
Hysen Osmanaj	anëtar
Vera Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit z. Suri Damzi, nga listat shumëmemërore për Këshillin e Bashkisë Lezhë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.



BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 11 i ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu V i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN:

Këshilli i Bashkisë Lezhë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në këshill për arsye të përfundimit para afatit të mandatit të njërit prej këshilltarëve.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore të subjektit politik Partia Balli Kombëtar Demokrat, ka plotësuar e depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit, si organi kompetent për administrimin, për verifikimin, për zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe për emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, z. Suri Ramiz Damzi, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, i subjektit politik Partia Balli Kombëtar Demokrat, është deklaruar si vijon:

- Në pikën 1 të formularit të vetëdeklarimit (A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?) ka deklaruar se:

- Me vendimin nr. 151, datë 12.12.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është dënuar për veprën penale: “Vjedhje energjie”, parashikuar

nga neni 137/1, Kodi Penal, dhe ndaj tij është vendosur masa e dënimit 6 (gjashtë) muaj punë;

- Me vendimin nr. 422, datë 25.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është dënuar për veprën penale: “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/“a”/1 Kodi Penal, dhe ndaj tij është vendosur masa e dënimit 18 (tetëmbëdhjetë) muaj shërbim prove.

- Në pikën 4 të formularit të vetëdeklarimit (A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e ndonjë vepre penale?) ka deklaruar se është ndaluar nga:

- Policia Gjyqësore Lezhë, në vitin 2007, për veprën penale: “Vjedhje energjie” dhe ndaj tij është marrë masa e dënimit me punë 6 (gjashtë) muaj;

- Policia Gjyqësore Lezhë, në vitin 2015, për veprën penale: “Ndërtim i paligjshëm” dhe ndaj tij është marrë masa e dënimit shërbim prove 18 (tetëmbëdhjetë) muaj.

- Në pikën 5 të formularit të vetëdeklarimit (A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo?) ka deklaruar se është caktuar masë e sigurisë personale:

- Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore;

- Arrest në burg.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe të kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 196 prot., datë 13.2.2018, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 197 prot., datë 13.2.2018, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. 423/1 prot., datë 15.2.2018, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar në këshillin bashkiak, sipas së cilës rezultoi se z. Suri Damzi është i rehabilituar. Drejtoria e Përgjithshme



e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë.

1. Në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 11 prot., datë 15.2.2018, z. Suli Damzi rezulton se: me vendimin nr. 422, datë 25.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, deklarohet fajtor për veprën penale: “Ndërtim i paligjshëm”, bazuar në nenin 199 të Kodit Penal dhe dënohet me 9 (nëntë) muaj burgim.

Në zbatim të nenit 406 të KP-së dënohet me 6 (gjashtë) muaj burgim.

Në zbatim të nenit 59 të KP-së pezullohet ekzekutimi i vendimit me burgim për një periudhë kohe prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajsh.

Referuar gërmës “ç”, të pikës 1, të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave të cilët janë dënuar me burgim, me vendim të formës së prerë, për kryerjen me dashje të një krimi që nuk përfshihet në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike dhe kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim.

Ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë së cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar/dënuar.

Sipas nenit 4 të ligjit të sipërcituar:

.....

4. Për personat që parashikohen nga shkronja “ç”, e pikës 1, të nenit 2 të këtij ligji, ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal.

.....

9. Ulja e masës së dënimit për shkak gjykimi të shkurtuar apo procedure të ngjashme me të që passjell uljen e dënimit, amnistia, depenalizimi, falja, pezullimi i dënimit, lirimi i parakohshëm me kusht apo çdo shkurtim i dënimit, në përputhje me ligjin, nuk ndikojnë në zbatimin e këtij ligji dhe nuk përllogariten në funksion të shkurtimit të afatit të dënimit, me qëllim shkurtimin e periudhës së ndalimeve të parashikuara nga ky ligj. Ky ligj nuk zbatohet për dënime të dhëna për dispozita që janë

shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, pas dhënies së dënimit përkatës, si dispozita në kundërshtim me Kushtetutën në fuqi në momentin e dënimit.

Referuar vërtetimit të gjendjes gjyqësore, në lidhje me veprën penale: “Ndërtim i paligjshëm”, bazuar në nenin 199 të Kodit Penal, z. Suli Damzi është dënuar me 9 (nëntë) muaj burgim. Në zbatim të nenit 406 të KP-së (seksioni II - Gjykimi i shkurtuar) Gjykata ka dhënë dënimin me 6 (gjashtë) muaj burgim dhe në zbatim të nenit 59 të KP-së ka pezulluar ekzekutimin e vendimit me burgim për një periudhë deri në 18 muaj.

Bazuar në pikën 9, të nenit 4, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ulja e masës së dënimit në 6 muaj nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, për shkak të gjykimit të shkurtuar, pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë, nuk ndikojnë në zbatimin e këtij ligji dhe nuk përllogariten në funksion të shkurtimit të afatit të dënimit, me qëllim shkurtimin e periudhës së ndalimeve të parashikuara nga ky ligj.

2. Sipas pikës 13, kreu V, të vendimit të Kuvendit 17/2016, nëse ekzistojnë të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2, i ligjit 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon nëse ato përfshihen brenda periudhës së ndalimit të përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr. 138/2015.

Referuar nenit 4, pika 4, të ligjit nr. 138/2015, periudha e ndalimit për ushtrimin e funksionit për personat e dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 2, pika 1, germa “ç”, e këtij ligji, ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë deri në momentin e rehabilitimit sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Referuar dispozitivit të vendimit nr. 422, datë 25.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për deklarimin fajtor për veprën penale: “Ndërtim i paligjshëm” dhe dënimin e tij me 9 muaj burgim bazuar në nenin 199 të Kodit Penal.

Referuar pikës 9, të nenit 4, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, sipas së cilës ulja e masës së dënimit nuk përbën shkak për gjykim të shkurtuar dhe nuk përllogariten në funksion të shkurtimit të afatit të dënimit, me qëllim



shkurtimin e periudhës së ndalimeve të parashikuara nga ky ligj.

Referuar nenit 69, të Kodit Penal, germa “b”, sipas të cilit quhen të padënuar: “ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga gjashtë muaj gjer në pesë vjet dhe që gjatë pesë viteve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale”, nuk është i rehabilituar.

Referuar masës së dënimit dhe datës kur vendimi nr. 422, datë 25.11.2015, ka marrë formë të prerë, është data 7.12.2015. Periudha e ndalimit të ushtrimit të funksionit, në aplikim të nenit 69 të Kodit Penal dhe pikës 4 dhe 9, të nenit 4, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, zgjat për një periudhë kohore prej 5 (pesë) vitesh deri në datën 6.12.2020.

Në bazë nenit 4, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për personat që parashikohen nga shkronja “ç”, të pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, për zgjedhje apo për ushtrim të funksionit zgjat deri në momentin e rehabilitimit sipas nenit 69 të Kodit Penal, 5 vjet nga momenti i i vuajtjes së dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, z. Suri Damzi, kandidat i listës shumëmemërore i subjektit Partia Balli Kombëtar Demokrat për anëtar të Këshillit të Bashkisë Lezhë, është brenda periudhës së ndalimit të ushtrimit të funksionit deri në datën 7.12.2020.

Neni 11, pika 2, e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, parashikon se:

Për kandidatët e listave shumëmemërore, për të cilët kryhet verifikimi, sipas pikës 1 të këtij neni, kur verifikohen kushtet e moszgjedhshmërisë, sipas këtij ligji, KQZ-ja shpall faktin e moszgjedhshmërisë së personit përkatës dhe procedon me kandidatin vijues, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

Për sa më sipër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar nenit 14 dhe nenit 11, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, shpall faktin se z. Suri Damzi është në kushtet e moszgjedhshmërisë në funksionin e anëtarit të Këshillit të Bashkisë Lezhë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; në nenin 11, të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; në kreun V të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

VENDOSI:

1. Të shpallë moszgjedhshmërinë si anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë të z. Suri Ramiz Damzi.
2. Ky vendim t’i njoftohet menjëherë Kryeministrit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 45 ditëve, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KRYETARI
Klement Zguri

NJOFTIM Nr. 3793, datë 7.3.2018

PËR BOTIMIN E DATËS SË HYRJES NË FUQI TË DISA MARRËVESHJEVE

Në datën 19 shkurt 2018, ka hyrë në fuqi marrëveshja ndërkombëtare si vijon:

- “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Evropian”, nënshkruar në Korçë, më 27.11.2017.

Në datën 1 mars 2018, ka hyrë në fuqi marrëveshja ndërkombëtare si vijon:

- “Konventa e Këshillit të Evropës kundër trafikimit të organeve njerëzore”, bërë në Santiago de Compostela, më 25.3.2015 dhe ratifikuar me ligjin nr. 150/2015, më 21.12.2015.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Gazmend Barbullushi

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 704, datë 31.1.2018, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Xhavid Salia, i datëlindjes 4.4.1951, në datën 15.5.1997.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 280 lekë